



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
SENATI AKADEMIK

Nr. 509/Prot.
12

Tiranë, më 24.05.2023

VENDIM

Nr. 25, datë 24/05/2023

MBI

**“MIRATIMIN E RREGULLORES SË PROGRAMIT TË STUDIMIT TË FORMIMIT
TË VAZHDUAR NË FUSHËN PSIKO-PEDAGOGJIKE PËR USHTRIMIN E
PROFESIONIT TË RREGULLUAR TË MËSUESIT, PRANË FAKULTETIT TË ARTIT
SKENIK, NË UNIVERSITETIN E ARTEVE”**

Senati Akademik i Universitetit të Arteve, mbështetur në pikën 1, shkronja d të nenit 38, në pikën 1 të nenit 71 si dhe në nenin 81 të ligjit nr. 80/2015, për “*Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*”, në nenin 24, pika 1, shkronja g të Statutit të Universitetit të Arteve, në shkresën Nr. 133 Prot., datë 12.05.2023 të Dekanatit të FAS, me lëndë “*Kërkesë për miratimin në Senatin e UART dhe Bordin e Administrimit të dosjes me dokumentacionin e duhur për hapjen e programit të studimit të vazhduar në fushën psiko-pedagogjike*”, pasi e shqyrtoi dhe diskutoi,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Rregullores së programit të studimit “Për formimin e vazhduar në fushën psiko-pedagogjike për ushtrimin e profesionit të rregulluar të mësuesit”, sipas materialit bashkëlidhur këtij vendimi, të dërguar nga Fakulteti i Artit Skenik.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Fakulteti i Artit Skenik, Sekretaria mësimore dhe Sektori mësimor dhe informimit të studentëve.
3. Ky vendim të publikohet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve dhe tek transparenca.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Kastriot ÇAUSHI

Prof. Najada HAMZAJ

Prof. Dr. Isak SHEHU

Prof. Petrit MALAJ

Prof. Artan PEQINI

Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA)

Prof. Arben LLOZI

Prof. Ilir MARTINI

Prof. Asoc. Dorian ÇENE

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Asoc. Dr. Kastriot TUSHA

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Prof. Endri SINA

Prof. Asoc. Edmond GJIKOPULLI

Prof. Asoc. Albes FUSHA

Prof. Asoc. Zamir KOKONOZI

Prof. Asoc. Genci FUGA


Erlind FUSHA (Student FAB)

Sindi ZDRAVA (Studente FM)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
FAKULTETI I ARTIT SKENIK



RREGULLORE E
PROGRAMIT TË STUDIMIT TË FORMIMIT TË VAZHDUAR NË FUSHËN
PSIKO-PEDAGOGJIKE PËR USHTRIMIN E PROFESIONIT TË RREGULLUAR
TË MËSUESIT

Miratuar me Vendim të Senatit Akademik të
Universitetit të Arteve

Nr. 25 datë 24 / 05 /2023



KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Baza ligjore

Baza ligjore e Rregullores së Programit të Studimit të Formimit të Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike për Ushtrimin e Profesionit të Rregulluar të Mësuesit, është:

1. Ligji Nr. 80 datë 17.09.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 81 i këtij ligji në, pikat 1, 2, 3 që lejon institucionet e arsimit të lartë për të zhvilluar programe të formimit të vazhduar.
2. Udhëzimin Nr. 3, datë 15.02.2023 i MAS “Për Përcaktimin e Diplomave Universitare të Njëvlershme, të Ngjashme ose të Përafërta me Fushën/Lëndët e Mësimdhënies në Arsimin Parauniversitar dhe Kriteret për Hapjen e Programeve të Studimeve të Formimit të Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike”
3. Statuti i UART.
4. Rregullorja e UART.
5. Aktet e brendshme rregullatorë të UART.

Neni 2 Objekti i Rregullores

Kjo Rregullore vendos rregullat normative për organizimin dhe funksionimin e “Programit të Studimit të Formimit të Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike për Ushtrimin e Profesionit të Rregulluar të Mësuesit” dhe të marrëdhënieve që krijohen midis subjekteve pjesëmarrëse në zhvillimin e këtij programi. Rregullorja përcakton misionin e studimit dhe të kualifikimit, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve; rregullat për pranimin e studentëve, për mësimdhënien, për vlerësimin, për certifikimin dhe parashikon sanksionet në rastin e shkeljes së rregullave.

Neni 3 Përmbajtja Programit të Studimit të Formimit të Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike

Plani mësimor përmban 6 (gjashtë) lëndë të formimit psiko-pedagogjik nga të cilat 5 (pesë) janë lëndë bazë, 1 (një) lëndë opsionale e cila vendoset sipas specifikave të UART dhe prova finale.

Qëllimi i përgjithshëm i programit të formimit është që studentët të fitojnë një sfond të gjerë dhe të qëndrueshëm shkencor si dhe kompetenca që lidhen me formimin psiko-pedagogjik në aspektin teorik dhe atë praktik, që u mundëson ushtrimin e profesionit të mësuesisë, sipas fushës përkatëse të studentit në formimin e mëparshëm universitar.

KREU II ORGANIZIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Neni 4 Organizimi administrativ

Përgjegjësinë për organizimin e Programit të Studimit të Formimit të Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike për Ushtrimin e Profesionit të Rregulluar të Mësuesit në Universitetin e Arteve, e ka Departamenti Aktrim dhe Teori në Fakultetin e Artit Skenik.



Neni 5

Koordinimi dhe këshillimi

1. Departamenti Aktrim dhe Teori në Fakultetin e Artit Skenik, ka koordinatorin për programin i cili mban lidhjet me Departamentin dhe Fakultetin e Artit Skenik si dhe fakultetet e tjera në UART. Koordinatorin koordinon aktivitetet rreth organizmit, menaxhimit dhe zhvillimit të programit, si dhe këshillon studentët në lidhje me këtë program.
2. Stafi akademik i programit i këshillon studentët në lidhje me lëndët përkatëse.

Neni 6

Programi i studimit të vazhduar

Programi i Studimit të Formimit të Vazhduar ofron një formim të specializuar në fushën psiko-pedagogjike dhe drejton studentin/ët drejt specializimit të profesionit të mësuesisë. Ai realizohet me:

- 35 kredite;
- ofrohet me kohë të plotë.

Neni 7

Afati dhe e drejta e studimeve

Kohëzgjatja normale e studimit për Programin e Studimit të Formimit të Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike me 35 kredite është 4-5 muaj ose 1 (një) semestër akademik.


Neni 8

Politika e regjistrimit dhe frekuentimit

1. Në këtë Program regjistrohen ata kandidatë:
 - a. Që kanë mbaruar studimet universitare konform ankesit 1. të Udhëzimit Nr. 3, datë 15.02.2023 i MAS “*Për Përcaktimin e Diplomave Universitare të Njëvlershme, të Ngjashme ose të Përafërta me Fushën/lëndët e Mësimdhënies në Arsimin Parauniversitar dhe Kriteret për Hapjen e Programeve të Studimeve të Formimit të Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike*”
 - b. Që kanë diplomë të ciklit të dytë Master i Shkencave, Master i Arteve ose Master Profesional, të ciklit katërvjeçar me 8 (tetë) semestra ose ekuivalente me to, të lëshuara nga institucione të arsimit të lartë, programi i studimit të së cilave përputhet me një nga fushat / lëndët e mësimdhënies në arsimin parauniversitar të përcaktuar në aneksin 1 të Udhëzimit Nr. 3, datë 15.02.2023 i MAS.
2. Frekuentimi i studentëve është i detyrueshëm për të gjitha modulet/lëndët mësimore dhe provën finale.
3. Studenti duhet të ndjekë të gjitha format e mësimdhënies të disiplinave të përcaktuara në planin mësimor. Masa e detyrueshme për frekuentimin e tyre përcaktohet nga aktet rregullatorë të UART.
4. Mungesa në mësim në programet me kohë të plotë është e pranuar deri në masën 25% të orëve mësimore të parashikuara në auditor.

Neni 9

Procedura për frekuentimin



1. Për format e mësimit me frekuentim të detyruar, kur studenti me ose pa arsye nuk merr pjesë në mbi 25% të orëve të zhvilluara në një lëndë, ai shpallet i pa klasifikuar dhe nuk lejohet të shlyejë detyrimet e mëtejshme të asaj lënde. Studenti është i detyruar të ndjekë përsëri format e mësimit në vitin pasardhës, duke përmbushur të gjitha detyrimet që rrjedhin nga rregulloret për këtë procedure.
2. Pedagogu i lëndës njofton Përgjegjësën e Njesisë Bazë dhe Sekretarinë mësimore me shkrim për studentët të cilët kanë arritur masën 25% të mos frekuentimit të procesit mësimit. Në rastet e mos njoftimit për frekuentimin e procesit mësimit nga studenti, pedagogu duhet të mbajë përgjegjshmëri administrative.
3. Pjesëmarrja e studentit evidentohet rregullisht dhe monitorohet nëpërmjet regjistrit të kursit/grupit. Sekretaria mësimore monitoron rregullisht frekuentimin e studentëve në procesin mësimit, evidenton ç' do shkelje të kufijve minimal të pranuar në bazë edhe të raportimit të pedagogut të lëndës. Sekretaria mësimore informon Dekanin me shkrim, rast pas rasti, për shkeljet e konstatuara. Këto raste i bëhen të njohura me shkrim edhe studentit.

Neni 10 **Struktura e studimeve**

1. Cikli i studimit: Programi i Studimit të Formimit të Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike.
2. Emërtimi i Certifikatës: **“Certifikatë e Programit të Formimit të Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike” në Arte.**
3. Kohëzgjatja e Programit të Studimit të Vazhduar dhe Kualifikimit: 4-5 muaj (1 semestër).
4. ECTS total: 35 ECTS.
5. Forma e zhvillimit të programit: Me kohë të plotë.

Neni 11 **Plani mësimit**


1. Plani mësimit përmban 5 (pesë) lëndë mësimore bazë, 1 (një) lëndë opsionale që vendoset sipas specifikave të UART dhe provën finale. Plani mësimit ndërtohet me lëndë të formimit të domosdoshëm psiko-pedagogjike, konform materialit të dakordsuar dhe miratuar nga Grupi i Punës i Urdhëruar nga MAS me Urdhër Nr.115, datë 27.02.2023.
2. Plani mësimit miratohet me vendim të Senatit Akademik të UART.

Neni 12 **Programi i lëndës**

1. Programi i lëndës hartohet dhe nënshkruhet nga titullari i saj, sipas formatit standard të miratuar nga Senati Akademik i UART dhe konform VKM Nr. 41, datë 22.2.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”.
2. Programet e lëndëve depozitohen në Departament.

Neni 13 **Format e mësimit**

1. Procesi mësimit me studentët përfshin një larmi formash të mësimit dhe të kontrollit të dijeve. Këto forma harmonizohen midis tyre përmes raporteve të caktuara të parashikuara në planin mësimit, programet e lëndëve, dhe rregulloren mësimore të programit të studimit.



2. Veprimtaria mësimore realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike, leksioneve, seminareve, diskutimeve, debatit, punës në grupe, studimit të rastit, simulimeve, prezantimeve, praktikës.
3. Kohëzgjatja e seancave mësimore është 50 minuta.
4. Veprimtaria mësimore e programit zhvillohet në gjuhën shqipe.

Neni 14 **Praktika**

Komponenti i praktikës zhvillohet pas përfundimit të këtij programi dhe menaxhohet nga Njësia Bazë Aktrim dhe Teori në bashkëpunim me institucionet para universitare në varësi të Zyrave Arsimore Vendore, ku ka vendbanimin studenti, me një afat kohor konform ligjeve në fuqi, që adresojnë licensimin e profesionit të mësuesisë dhe është objekt monitorimi dhe vlerësimi nga ZVA-të.

KREU III **VLERËSIMI I STUDENTIT**

Neni 15 **Kriteret dhe procedurat e vlerësimit**

1. Në Universitetin e Arteve vlerësimi i njohurive të studentit bëhet me notë. Për notat, përdoret sistemi shqiptar i vlerësimit me 10 nota, nga 1 tek 10, ku nota 10 është vlerësimi maksimal. Notat nga 5 (pesë) e lartë janë kaluese.
2. Kriteret dhe format e vlerësimit të studentit përcaktohen në planin mësimor, në programin e lëndës dhe i bëhen të njohura studentëve në fillim të programit.
3. Vlerësimi në një lëndë mund të bëhet:
 - a) me provim me shkrim, me gojë ose i kombinuar;
 - b) me detyra kursi, projekte, ese, etj.;
 - c) i bazuar në një shumëllojshmëri formash vlerësimi.
4. Vlerësimi për secilën lëndë mësimore kryhet në mënyrë të vazhdueshme dhe në përfundim të saj.
5. Notat vendosen në bazë të pikëve.
6. Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistemin prej dhjetë notash.

Neni 16 **E drejta për të hyrë në provim**

1. Studenti fiton të drejtën të futet në provimin e një lënde, kur:
 - a) ka plotësuar kriteret detyruese të vendosura për atë lëndë të parashikuara në planin mësimor;
 - b) e lejon grafikun e ndërvarësisë së lëndëve;
 - c) plotëson kushtet që lidhen me frekuentimin e formave mësimore;
 - d) ka mbrojtur detyrimet për praktikën mësimore, punët laboratorike, nëse lënda parashikon formate tilla, brenda afatit të parashikuar në grafikun e detyrimeve, para fillimit të sezonit të provimeve;
 - e) të jetë regjistruar në sekretarinë mësimore përkatëse;
 - t) ka paguar tarifën e shkollimit.
2. Studenti i cili nuk plotëson këto parakushte, nuk lejohet për asnjë lloj arsye të hyjë në provimin e lëndës përkatëse.



Neni 17

Zhvillimi i provimeve

1. Provimet zhvillohen në përfundim të programit, duke përcaktuar një sezon 2 javor për përfundimin e tyre. Dekani i Fakultetit të Artit Skenik, përcakton me urdhër me shkrim masat që duhet të merren për organizimin e provimeve.
2. Provimet dhe riprovimet, detyrat e kursit dhe prezantimet zhvillohen sipas afateve të caktuara në strukturën e vitit akademik.
3. Nëse studenti nuk ka shlyer detyrimet e lëndës në kohën normale të zhvillimit të saj, ai duhet t'i shlyejë ato para fillimit të sezonit të provimeve, në periudhën e shpallur nga Dekani.
4. Nuk lejohet shlyerja e detyrimeve të lëndës përgjatë sezonit të provimeve.
5. Studenti, nuk lejohet të hyjë për të dytën herë në provimin e një lënde, brenda të njëjtit sezon.
6. Studenti është i detyruar të paraqitet në provim me një dokument identifikimi.
7. Studenti nuk mund të hyjë në të njëjtën ditë në dy provime në lëndë të ndryshme.
8. Provimet me shkrim, bëhen të sekretuara dhe zgjasin 2-4 orë.
9. Në rast pamundësie të jashtëzakonshme të zhvillimit të provimit ose të prezantimit ditën e caktuar, Dekani, me urdhër me shkrim, cakton një datë tjetër të mëvonshme brenda sezonit apo jashtë sezonit por jo më vonë se pesë ditë nga përfundimi i sezonit përkatës të provimeve e cila u bëhet e njohur studentëve dhe pedagogëve.
10. Provimet vlerësohen nga pedagogu/pedagogët që kanë zhvilluar lëndën.
11. Në të gjitha format e organizimit të provimit, studenti merr vlerësimin nga komisioni jo më vonë se tre ditë pune nga data e dhënies së provimit.

Neni 18

Riprovimi

1. Studenti ka të drejtë të ankohet, në rast se ndaj tij janë shkelur rregullat procedurale gjatë zhvillimit të provimit ose është bërë vlerësim i pamërituar për përgjigjen që ka dhënë. Ankesa duhet të depozitohet me shkrim brenda një afati prej 24 orësh nga shpallja e rezultatit. Kjo ankesë shqyrtohet nga Dekani, i cili mund të thërrasë për sqarime komisionin e provimit dhe vetë studentin dhe pas gjykimit të çështjes, merr vendimin përkatës të formës së prerë brenda tre ditëve.
2. Vendimi i Dekanit përcakton nëse kërkesa e studentit është e drejtë ose jo. Kur ankesa është e drejtë, Dekani e shpall të pavlefshëm rezultatin e vlerësimit për të cilin studenti është ankuar dhe vendos që studenti të japë përsëri provimin me të njëjtin komision dhe nën monitorimin e një përfaqësuesi të caktuar nga Dekani, në një datë tjetër brenda sezonit ose jashtë tij, por jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga përfundimi i sezonit përkatës të provimeve.

Neni 19

Dokumentimi i vlerësimeve

1. Fleta e Provimit është dokumenti i vetëm i cili dokumenton vlerësimin e studentit në provim. Prezenca ose jo e emrit të studentit në Fletën e Provimit (për arsye të përcaktuara në rregulloret) përcakton edhe hyrjen ose jo të studentit në provim. Fleta e Provimit hartohet mbi bazën e grupit. Në Fletën e Provimit shënohen vetëm studentët që kanë fituar të drejtën të hyjnë në provim.



2. Fleta e Provimit i dorëzohet komisionit të provimit ditën e provimit. Me përfundimin e provimit, kryetari i komisionit e dorëzon atë në sekretari. Në asnjë rast Fleta e Provimit nuk duhet të ketë korrigjime dhe askush nuk ka të drejtë të shtojë emra në të.
3. Nota e provimit shënohet me numër e me fjalë dhe firmoset nga të gjithë anëtarët e komisionit.
4. Për studentin që nuk paraqitet në provim, në Fletën e Provimit shënohet cilësimi "nuk u paraqit". Për studentët që kanë përmbushur 25% të mos frekuentimit, shënohet në Fletën e Provimit cilësimi "nuk fiton". Fleta e Provimit e plotësuar në rregull, dorëzohet në sekretarinë mësimore brenda afateve të përcaktuara por jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e dhënies së provimit. Parregullsitë që lidhen me plotësimin apo me dorëzimin e këtij dokumentacioni, ngarkojnë me përgjegjësi Kryetarin e komisionit dhe pedagoget anëtarë të komisionit.
5. Në përfundim të provimit, kryetari i komisionit të provimit, në praninë e anëtarëve të komisionit, aksesohet në sistem dhe pasqyron vlerësimin e komisionit për secilin prej studentëve në përputhje me Fletën e Provimit. Procesverbali i Provimit shkarkohet nga sistemi nga kryetari i komisionit dhe nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit. Procesverbali i Provimit i plotësuar në rregull, dorëzohet në sekretarinë mësimore brenda afateve të përcaktuara por jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e dhënies së provimit.
6. Parregullsitë që lidhen me plotësimin apo me dorëzimin e këtij dokumentacioni, ngarkojnë me përgjegjësi kryetarin e komisionit dhe anëtarët e tij.
7. Në rast të gabimeve në plotësimin e Fletës së Provimit, hartohet një procesverbal me firmat e anëtarëve të komisionit dhe me miratimin e Dekanit, lëshohet një fletë e re provimi.

KREU IV CERTIFIKIMI

Neni 21 Procedura e Certifikimit

1. Certifikimi i studenti bëhet pasi ai/ajo ka shlyer të gjitha provimet e lëndëve sipas planit mësimor, si dhe provën finale.
2. Certifikata nënshkruhet nga Dekani i Fakultetit të Artit Skenik dhe Rektori i UART.

Neni 22 Marrja e certifikatës

Tërheqja e certifikatës bëhet personalisht nga studenti i certifikuar, kundrejt nënshkrimit dhe evidentohet në regjistrin e diplomave/certifikatave.

KREU V PRANIMI I STUDENTËVE

Neni 23 Politika dhe kriteret e pranimit

1. Pranimi i kandidatëve bëhet me aplikim të studentëve. Kandidati aplikues duhet të zotërojë një diplomë të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor që të jetë në fushë lëndët e arsimit të mesëm të ulët dhe arsimit të mesëm të lartë konform aneksit 1 të Udhëzimit Nr. 3, datë 15.02.2023 i MAS "Për Përcaktimin e Diplomave Universitare të Njëvlershme, të Ngjashme ose të Përafërta me Fushën/lëndët e Mësimdhënies në Arsimin Parauniversitar".

dhe Kriteret për Hapjen e Programeve të Studimeve të Formimit të Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike”

2. Kandidati duhet të ketë edhe Diplomë të ciklit të dytë Master i Shkencave, Master i Arteve ose Master Profesional, diplomë të sistemit 4 vjeçar (sipas përcaktimeve të Ligjit 80/2015 neni 124 pika 2) apo ekuivalente me to, të lëshuara nga institucione të arsimit të lartë, programi i studimit të së cilave përputhet me një nga fushat/ lëndët e mësimdhënies në arsimin parauniversitar të përcaktuar në aneksin 1 të Udhëzimit Nr. 3, datë 15.02.2023 i MAS.
3. Për aplikantët që kanë fituar diplomë/diploma studimi jashtë vendit, duhet të kenë ekuivalentuar studimet e tyre në institucionet përgjegjëse në Shqipëri, por dhe që janë konform kërkesave të pikës 1 të këtij neni.

Neni 24 **Dokumentacioni i pranimit**

- a) Formularin e aplikimit.
- b) Fotokopje e kartës së identitetit.
- c) Curriculum Vitae.
- d) Diploma e maturës, diplomat e studimeve të larta *universitare (bachelor, master shkencore, diplomë e studimeve të integruara)*, sipas kriterëve të parashtruara në nenin 8, pikën 1 dhe 2 të kësaj rregulloreje.
- e) 2 fotografi me format pasaporte.
- f) Fletëpagesa e tarifës së regjistrimit.

Neni 25 **Informacioni për kriteret dhe procedurat e pranimit**

Informacioni për kriteret dhe procedurat e pranimit publikohen:

- Në faqen zyrtare të web-it të UART.
- Në formatin e printuar në formën e guidave, rregulloreve, fletëpalosjeve të cilat gjenden në sekretari dhe u vihen në dispozicion të interesuarve.
- Të shpallura në mjediset e Fakultetit përkatës.

KREU VI **STUDENTËT**

Neni 26 **Të drejtat e studentëve**

Studentët kanë këto të drejta:

- a. Të udhëhiqen nga rregulla dhe procedura të formuluar qartë dhe të justifikuar në aspektin akademik.
- b. Të jenë të mbrojtur nga diskriminimi i çdo lloji ose nga ndonjë kriter i papërshtatshëm i vlerësimit akademik.
- c. Të kenë në dispozicion të gjithë informacionin që u takon të kenë për të gjitha çështjet akademike dhe veprimtarinë e shkollës.
- d. Të përdorin pajisjet, ambientet bibliotekën dhe Internetin e UART, sipas rregullave përkatëse për të realizuar programin mësimor dhe punën e programuar në aktivitetin e tyre shkencor.
- e. Të paraqesin pikëpamjet e tyre pa frikë nga ndëshkimi.

- f. Të pajisen me certifikatë si dhe të gjitha dokumentet e tjera të nevojshme në përfundim të programit të studimit që kanë ndjekur.
- g. Të zhvillojnë praktika mësimore/profesionale në institucionet që kanë marrëveshje bashkëpunimi me UART.
- h. Të refuzojnë të kryejnë detyra që nuk lidhen me zhvillimin profesional.

Neni 27 **Përgjegjësitë e studentëve**

Studentët kanë këto përgjegjësi:

- a. Të njohin dhe të zbatojnë Rregulloren e UART, Rregulloren “Programit të Studimit të Formimit të Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike për Ushtrimin e Profesionit të Rregulluar të Mësuesit”, kërkesat e programit të studimit dhe të jenë të vetëdijshëm për zbatimin e tyre, në të kundërtën, UART nuk mban përgjegjësi për pasojat që mund të rrjedhin nga mosnjohja dhe mos zbatimi e tyre.
- b. Të respektojnë Kodin e Etikës dhe të sillen në një mënyrë profesionale dhe qytetare në ambientet dhe tërë ndërveprimet e tyre në institucion, me drejtuesit, personelin akademik dhe administrativ, studentët e tjerë dhe bashkëpunëtorët e departamentit.
- c. Të përmbushin në kohë të gjitha kërkesat dhe detyrimet e programeve lëndore dhe të praktikës.
- d. Të respektojnë kohën e pedagogëve.
- e. Të paguajnë tarifën e regjistrimit dhe tarifën e studimit në afatet e caktuara.
- f. Të mbajnë përgjegjësi për shkeljet e rregullave UART nga ana e tyre.

Neni 28 **Përgjegjësitë e Departamentit Aktrim dhe Teori**

- a) Departamenti i jep studentëve gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me Rregulloren, politikën e zhvillimit të programit, kriteret e pranimit, planin dhe programet lëndore, rregullat e vlerësimit, rregullat e certifikimit, rregullat financiare.
- b) Respekton të gjitha kriteret profesionale, shkencore dhe pedagogjike për mësimdhënien, praktikën, vlerësimin.
- c) Asiston studentët në plotësimin e kërkesave që lidhen me zbatimin e programit të studimit.
- d) Krijon kushtet e përshtatshme për realizimin e programit (siguron mjediset, rrjetin e informacionit, vë në dispozicion bibliotekën, mjete mësimore dhe teknologjinë elektronike).

KREU VII **DISPOZITA TË FUNDIT**

Neni 29

1. Kjo rregullore mund të përmirësohet ose të korrigohet gjatë punës pjesërisht ose tërësisht nga Departamenti Aktrim dhe Teori në Fakultetin e Artit Skenik.
2. Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit në Senatin Akademik të UART.
3. Të drejtën e interpretimit të kësaj Rregulloreje e ka Zyra Juridike e UART.

Tiranë, Mars 2023

Përgjegjës i Departamentit Aktrim dhe Teori

Prof. Gazmend Gjoka